



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2018:014694

Datë: 15.08.2018

Numri i dokumentit: 00108988

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC

28.09.2018

P.nr.627/18



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal me kryetarin Adem Shabani me zyrtaren Ligjore Kadishe Shabani, procesmbajtëse në çështjen penale kundër të akuzuarve [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] nga Ferizaj me vendbanim në rrugën "[REDACTED]", të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/nr.639-5/2018 e datës 03.05.2018, me të cilën kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga 188 par. 2. lidhur me parë 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Valdet Avdiu, dhe të akuzuarve, me datën 15.08.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve:

1. [REDACTED], nga Ferizaj me vendbanim në rrugën "[REDACTED]", i lindur më [REDACTED], në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovëska të kryer shkollën fillore, punon, i martuar baba i një fëmije i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED], mbrohet në liri.
2. [REDACTED] nga Ferizaj me vendbanim në rrugën "[REDACTED]", i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovëska të kryer shkollën fillore, me profesion moler, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED] mbrohet në liri.
3. [REDACTED], nga Ferizaj me vendbanim në rrugën "[REDACTED]", i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovëska të kryer shkollën e mesme, i martuarë baba i tre fëmive me

profesion moler i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

SEPSE:

- më datën 08.03.2018, rreth orës 13:30, në Ferizaj, rruga " Vllëzrit Gërvalla ", saktësisht përballë marketit " Mentori Center ", pas një mosmarrëveshje ku paraprakisht i dëmtuari ishte takuar me të pandehurin e pare tek " Meridian Expres ", përballë Komunës, ku edhe ishin fjalosur rreth një borgji, të pandehurit në bashkëkryerje e kishin sulmuar me mjet të forte-shkop druri, mjet ky i përshtaëshëm për ti shkaktuar lëndime të rënda trupore të dëmtuarit [REDAKTUAR], në atë mënyrë që pasi e kanë takuar të dëmtuarin rrugës tek marketi "Mentori", e kanë goditur me mjet të forte shkop druri, në kokë, krahun e majtë dhe pjesë të ndryshme të trupit, duke e lënë të shtrir në tokë, me ç'rast nga këto goditje i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore me pasojë të përkohshme të shëndetit të përshkruar në ekspertizen mjeko ligjore të datës 18.04.2018,-

-me të cilën ka kryer veprën penale në lëndim i rëndë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me parë 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4, 7, 17, 23, 41, 42. 43, 45, 46, 48 par.1 , 49, 50, 51, 52 dhe 73 të KPK-së dhe nenit 365 të KPPK-së i

GJYKON

I. Të akuzuarin [REDAKTUAR] me denim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Gjykata konform nenit 48 par.1 të KPRK-së me pëlqimin e personit të dënuar dënimin me burgim i'a zëvendëson me urdhrin për punë në dobi të përgjithshme duke llogaritur (8) orë të punës në dobi të përgjithshme.

Gjykata i urdhëron të dënuarin për dënimin e shqiptuar të kryej punë në dobi të përgjithshme pa pagesë për një periudhe të caktuar kohore prej njëqind e katër dhjetë orë (140) orë pune.

Shërbimi Sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet kryer nga i dënuari, cakton organizatën e veçantë për të cilën personat e dënuar do të kryejnë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe e mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme.

Puna në dobi të përgjithshme nga ana e të dënuarit duhet të kryhet brenda gjashtë muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personat e dënuar nuk e kryejnë punën në dobi të përgjithshme ose e kryejnë vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata

urdhëron dënimin me burgim ku një ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë punë në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

II. Të akuzuarin [REDAKTUAR], me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

III. Të akuzuarin [REDAKTUAR], me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimi me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të marrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

I dëmtuari [REDAKTUAR], nga Ferizaj, rruga [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në Kontest Civil.

Obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguajnë shumën prej 20 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 60 Euro, gjithësej 80 € në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç të paguajnë nga 30 Euro, për taksë, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/nr.639-5/2018 e datës 03.05.2018 ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga Ferizaj me vendbanim në rrugën "[REDAKTUAR]", lëndim i lehtë trupor nga 188 par. 2. lidhur me parë 1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.15.08.2018, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Valdet Avdiu, të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kurse i dëmtuari [REDAKTUAR] nuk ishte prezent por nga fletë kthesa për dorëzim persona shpërndarësi i ftesave ka konstatuar se ai gjendet në burg .

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari ka konstatuar se të akuzuarit në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim fillestar , kanë pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në fillim të shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarve janë respektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën dhe pasi që gjyqtari është bindur se të njëjtit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën veç e veç janë akuzuar, të njëjtëve i ka dhënë mundësi të deklarohen mbi fajësinë apo pafajësinë e tyre lidhur me veprën penale për të cilën akuzohen.

I akuzuari [REDAKTUAR], ka deklaruar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe në tërësi mbështet deklaratën që ka dhënë në

polici por pas këtij rasti i dëmtuari [REDAKTUAR] i ka dalë dhe e ka sulmuar ku i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje të dorës goditje me këmbë në qafë ku e ka lënë të shtrirë në tokë ku nga policia është dërguar në spital e për këtë rasti [REDAKTUAR] gjinde në burg, është hera parë që ndeshet me ligjin, pendohet për veprën penale që e ka kryer i kërkon falje publike gjykatës dhe premtion se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale të tilla dhe kërkon nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të merre për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese pasi tani edhe ky është i dëmtuar ku lëndimet i ka pësuar nga [REDAKTUAR] i cili në këtë çështje penal është në cilësinë e të dëmtuarit.

I akuzuari [REDAKTUAR], ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim ka theksuar se kur e ka parë vëllain e tij [REDAKTUAR] se është duke e rrahur nga [REDAKTUAR] ka shkuar që të ndërhyr për ndarje pa asgjë në dorë nuk ka pasur dhe nga kjo ndërhyrje nuk ka mundur që të përmbahet ku nuk e mohon se ndoshta i ka mëshuar të dëmtuarit pendohet për veprën e kryer, është hera e parë që ndeshet me ligjin.

I akuzuari [REDAKTUAR] ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe në vazhdim pranon se ka marrë pjesë edhe ky në këtë rrahje por kishte shkuar që ti ndanë mirëpo ka humbur kontrollin dhe ka mundur që të godas të dëmtuarin kërko falje për kryerjen e kësaj vepre penale, është hera e parë që ndeshet me ligjin është i martuar dhe baba i tre fëmijëve ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të marre për bazë theksimet e cekura në shqyrtimin e sotëm gjyqësor

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e kanë bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurorja i shtetit Valdet Avdiu ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi pranimi i fajësisë është bërë komfor ligjit dhe provat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe kërkon nga gjykata që të njëjtit ti shpallë fajtor dhe ti shqiptoj sanksion të paraparë me ligj.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuarit pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale, në deklaratat e tyre që kanë dhënë gjatë procedurës paraprake si dhe në ekspertizën e ekspertit të mjekësisë ligjore të datës 18.04.2018,5 lidhur me lëndimet që ka pësuar i dëmtuari, deklarata e të pandehurve e datës 13-14.03.2018, deklarata e të dëmtuarit e datës 13.03.2018 dhënë në prokurori si dhe në shkresat tjera që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] manifestohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga 188 par. 2. lidhur me parë 1 dhe nenin 31 të KPRK-së, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 2. të KPRK-së .

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre, në shqyrtimin fillestar, janë penduar për veprat penale që i kanë kryer, pas kryerjes së kësaj vepre penale i dëmtuari [REDAKTUAR] i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të pandehurit [REDAKTUAR] gjatë shqyrtimit fillestar kanë pasur sjelle korrekte dhe kanë qenë të sinqertë, i kanë premtuar gjykatës se më nuk do të përsëritin veprime të tilla mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin veç e veç si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarve dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së , të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rruga " [REDAKTUAR] ", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjell në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së dhe nenit 39 parag.1 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.627/18 me datë 15.08.2018

Zyrtare Ligjore
Kadishe Shabani

Gjyqtari

Adem Shabani



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhri ndëshkimor bëhet i plotfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.